



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 432 prot.

Tiranë më 26. 2. 2018

VENDIM

Nr. 10, datë 26. 2. 2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Z. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1470 Prot., datë 07.11.2017, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Bankës së Shqipërisë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën e datës 10.10.2017 ka kërkuar nga Autoriteti Publik ti vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me:

1. *Kopje të listës së kompanive dhe investimeve të tyre, të cilat janë marrë si bazë për raportin "Investimet e huaja direkte: përshkrim metodologjik dhe informacion statistikor për vitin 2015", botuar nga Banka e Shqipërisë, Departamenti i statistikave financiare, shtator 2016.*

Autoriteti Publik me shkresën nr. 4665/1 Prot., datë 24.10.2017 ka kthyer përgjigje duke refuzuar dhënien e informacionit me argumentin si më poshtë vijon: *Bazuar në Ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004, "Për statistikat zyrtare" i ndryshuar (neni 15 i tij mbi*

konfidencialitetin) dhe Kodit të Praktikave për Statistikat i Bankës së Shqipërisë (pika 5 mbi parimin e konfidencialitetit), Banka e Shqipërisë siguron ruajtjen e konfidencialitetit të njësive raportuese dhe këto njësi garantohen se disponimi mbi informacionin do të jetë i kufizuar, vetëm për qëllime statistikore, studimore dhe rregullatore dhe në asnjë rast nuk do t'i vihet në dispozicion palëve të treta, qofshin këto institucione publike apo entitete private të natyrave të ndryshme.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1470 Prot., datë 07.11.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me Urdhrin nr. 290 datë 16.11.2017, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që janë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit, Koordinatorja për të drejtën e informimit kërkoi kohë për sqarime më të detajuara lidhur me objektin urdhër inspektimi. Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1470/3 Prot., datë 21.11.2017, ka kthyer përgjigje duke argumentuar ndër të tjerat se: *Banka e Shqipërisë e merr informacionin mbi listën e kompanive nga Instituti i Statistikave (INSTAT) të kriptuar dhe mund të hapet vetëm nga një përdorues, i cili ka të drejta në këtë databazë, duke nënshkruar me INSTAT një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave. Lidhur me këtë informacion, kompanitë sigurohen nëpërmjet "Udhëzuesit për raportimet mbi investimet e huaja direkte" dhe klauzolës së "Konfidencialitetit" të vendosur në formularin e raportimit se, informacioni i marrë do të përdoret vetëm për qëllime statistikore si dhe do të ruhet konfidencialiteti i tyre. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë, si agjenci statistikore kontrollohet nga EUROSTAT mbi plotësimin e parimeve të Kodit të Praktikave Evropiane. Në raportin e kësaj të fundit theksohet se duhet të garantohet në mënyrë absolute privatësia e siguruesve të të dhënave, konfidencialiteti i informacionit që ata japin dhe përdorimi i të dhënave vetëm për qëllime statistikore".*

Në vijim të inspektimit pranë Autoritetit Publik, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24 pika 3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se *"Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve"*, me shkresën nr. 1470/4 Prot., datë 12.12.2017, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore e cila u zhvillua me datë 05.01.2018. Gjatë seancës, ankuesi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Qendra Res Publica, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" nuk mund të refuzohet kur ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të interesit publik, nuk zbatohet kur të dhënat përkatëse janë të dhëna statistikore.

Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar, rezultoi se Autoriteti Publik zotëron informacionin e kërkuar, vërtetuar kjo nga formulari “Raportimi tre-mujor i investimeve të huaja direkte”.

Autoritetit Publik, Bankës së Shqipërisë nuk i kërkohet që të bëjë publik informacionin dhënë nga INSTAT. Në këtë rast kërkohet i njëjti informacion statistikor i bërë publik nga vetë Banka e Shqipërisë, por në një mënyrë të ndryshme.

Rrjedhimisht, informacioni i sipër kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se informacioni i kërkuar duhet vënë në dispozicion duke respektuar parashikimet e nenit 15 të Ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar, pikës 5 të Vendimit nr. 19, datë 29.3.2017 “Kodi i Praktikave për Statistikat në Bankën e Shqipërisë” si dhe nenit 17 pika 6 të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se: “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit...*”.

Thëksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e Qendrës “Res Publica” ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’.

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit nr. 1470 Prot., datë 07.11.2017 të Qendrës “Res Publica”, përfaqësuar nga Z. _____, kundër Autoritetit Publik “Banka e Shqipërisë”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (*Kopje të listës së kompanive dhe investimeve të tyre, të cilat janë marrë si bazë për raportin "Investimet e huaja direkte: përshkrim metodologjik dhe informacion statistikor për vitin 2015", botuar nga Banka e Shqipërisë, Departamenti i statistikave financiare, shtator 2016*), brenda datës 5 . 3 .2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u shpall sot në datë 26 . 2 .2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

